REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:168175

Datë: 16.09.2020

Numri i dokumentit: 01117057

P.nr.515/2008

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Krimeve të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtaret: Isuf Makolli – kryetar, Shpresa Hasaj-Hyseni dhe Suzana Qerkini – anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Kimete Mehmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.Rr., për veprat penale: Mbajtja në pronësi, kontroll në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe G.S., për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPK, dhe A.S., për veprën penale Dëmtimi i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par.1 të KPK-së, te akuzuar sipas aktakuzës PP.nr.551-3/2008, të datës 26.08.2008 të ish Prokurorisë Publike të Qarkut tani Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, pas shqyrtimit gjyqësor, te hapur për publikun, të mbajtur me dt.11.09.2020, në të cilin të pranishëm: prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, i akuzuari D.Rr., të njëjtën ditë, me datë 11.09.2020, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

D.Rr., nga i ati R., dhe nenës B., e gjinisë Ll., i lindur me (data e lindjes...), në fshatin B., Komuna e P., ku edhe banon, me nr personal..., i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nen masën e arrestit shtëpiak prej datës 01.08.2008 deri me datë 01.09.2008.

I

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me datë 01.08.2008 rreth orës 10:53, në Prishtinë, pas një konflikti rreth parkimit të veturave, i pandehuri D. me qellim frikësimi ka nxjerrë revolen nga vetura Mercedes 190 të tipit Ekol model P-29 e kal 7.65, të cilën e mbante pa autorizim dhe me te njëjtën i kërcënon të pandehurit G.S. dhe A.S.n, me fjalët “largohuni se ju vras”,-

2019:168176

- më këtë i akuzuari, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPK).

Andaj gjykata në bazë të neneve: 6, 11,15,41, 42, 43, të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarit i **SHQIPTON**

DËNIM ME BURGIM ME KUSHT

Në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari, brenda afatit prej një(1) viti nuk kryen ndonjë vepre tjetër penale.

Konform nenit 328 par.5 të KPK, konfiskohet, revolja e tipi Ekol P-29 të cilën e ka mbajtur i akuzuari pa lejen e organit kompetent.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20€ (njëzet) euro,** brenda afatit prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II

Ndaj të pandehurve:

G.S., i biri i A. dhe H., e gjinisë A., i lindur më (data e lindjes...) në fshatin D., komuna e P. me vendbanim në P., lagja K.R., rr.”Xh.A.”, pa.nr, ka te kryer shkollën fillore, taksist në të zezë, i gjendje se dobët ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikë së Kosovës.

A.S., i biri i H. dhe S., e gjinisë B., i lindur me (data e lindjes...) në fshatin D., komuna e P. me vendbanim në P., lagja K.R., rr.”Xh.A.”, pa.nr, ka te kryer shkollën fillore, taksist në të zezë, i gjendje se dobët ekonomike Shqiptar shtetas i Republikë së Kosovës

Konform nenit 363 par.1 nen par.1.3 të KPPRK-së.

REFUZOHET AKUZA

Sepse:
Te pandehurit G.S. dhe A.S., në kohë dhe vend si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, të pandehurit pas një konflikti qe kishin me të pandehurin D.Rr., rreth parkingut, i pandehuri G.S., me një mjet të fortë, e ka goditur të pandehurin tani të dëmtuarin D.Rr., në qafë, ku i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, ndërsa i pandehuri A.S. me kaçavidë ia ka shpuar gomat e veturës ë tipit Mercedes 190-,

- me këtë kishin për te kryer i pandehuri G.S., veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPK, dhe i pandehuri A.S. veprën penale Dëmtimi i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par.1 të KPK-së,

Sepse ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

2019:168176

Shpenzimet e procedurës penale për këtë pikë të akuzës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë - tan Prokuroria Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.551-3/2008, të dt.26.08.2008, e ka akuzuar të pandehurin D.Rr., se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të Kodit Përkohshëm Penal të Kosovës(KPK) , e G.S. për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1të KPK dhe A.S., për veprën penale Dëmtimi i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par.1 të KPK-së.

Aktakuza është konfirmuar , me aktvendimin KA.nr.494/2008 të datës 14.011.2008.

Gjykata, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt. 11.09.2020, në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Ilaz Beqiri dhe i akuzuari D.Rr.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari ka deklaruar: se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Gjykata, ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shteti lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuar, e i cili është pajtuar me pranimin e fajësisë, nga i pandehuri.

Gjykata, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuar për piken një të aktakuzës, mendimet të prokurorit të shtetit, i cili u pajtua me pranimin e fajësisë, gjykata bazuar në nenin 326 të KPPK, me aktvendim ka pranuar fajësinë nga i akuzuari, pasi qe gjykata është bindur se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësie, pranimi është bërë me vullnet dhe vetëdije të plotë, nga i akuzuar, dhe se janë përmbushur kushtet nga neni 248 i KPPK, për pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: pasi qe i pandehuri e pranoi fajësinë lidhur me veprën penale me të cilën ngarkohet sipas aktakuzës, kërkoi gjykatës qe i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit dhe si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga i akuzuari.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi: shpreh pendimin e thellë për veprimet e tija, i premtoi gjykatës se nuk do të përsëris raste të tilla, jeton në kushte të vështira ekonomike, lut gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqipton një dënim sa më të butë.

Gjykata me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe lartësisë së tij ndaj të akuzuarit D.Rr., mori për bazë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori: se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, sjelljen e më hershme të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, nuk ka pasur pasoja nga vepra penale, se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se i njëjti i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit, se me të do të ndikohet që të parandalohet i njëjti që të kryej ndonjë vepër penale në të ardhmen, se do t`i parandalojë personat e tjerë në kryerjen e veprës penale, se me të

2019:168176

mjaftueshëm do të shprehet gjykim shoqëror për veprën penale, se do të ndikohet në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, me çka në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 42 te KPK-së.

Sa i përket pikës dy të aktakuzës, kundër të akuzuarve G.S., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPK-së dhe A.S., për veprën penale Dëmtimi i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par.1 të KPK-së, gjykata ka konstatuar se ka arrit parashkrim absolut i ndjekjes penale me datë 01.08.2012 sepse veprat penale janë kryer me datë 01.08.2008.

Sipas nenit 91 par.6 të KPK ndjekja penale ndalohet ne çdo rast kur te ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit(ndalesa absolute e ndjekjes penale).

Vendim mbi konfiskimin e sendit- revole Ekol me nr. serik: T713512 me 6 fishek, u mor në bazë të nenit 328 par.5 të KPK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur konform nenit 450 par.1 dhe par.2 pika 2.1 lidhur me pikën 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 e 363 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi është i përpiluar me datën 16.09.2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
P.nr.515/2008 dt.11.09.2020.

Procesmbajtësja
Kimete Mehmeti

Kryetari i trupit gjykues,
Isuf Makolli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2019:168176